



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE

VENDIM

Nr. 40 Datë 16.04.2013

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 134, DATË 17.09.2012, TË
MARRËVESHJES SË FURNIZIMIT ME ENERGI ELEKTRIKE MIDIS
SHOQËRISË KESH SH.A/FPSH DHE SHOQËRISË CEZ
SHPËRNDARJE SH.A/FPP PËR PERIUHDHËN 01.01.2012 – 31.12.2014,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, dhe nenit 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 gërma ”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, i ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 date 23.06.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 16.04.2013, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

Vendosi:

1. Pika 8.3.ii e Vendimit nr. 134, datë 17.09.2012, ndryshuar me Vendimin nr. 160, datë 26.11.2012, mbi marrëveshjes së furnizimit me energji elektrike midis shoqërisë KESH sh.a/FPSH dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje/FPP, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në rastin e importit të një sasi më të vogël se humbjet reale ne rrjetin e shperndarjes, CEZ Shperndarje do të kompensoje këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a, deri në fund të muajit m+2. Në rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhës m+2, CEZ Shpërndarje sh.a është i detyruar të kompensoje KESH sh.a ne muajin m+3, me vleren monetare qe i korrespondon kostove oportune te shkaktuara dhe te identifikuara nga KESH sh.a per sigurimin e kesaj sasi te energjise elektrike. Në mungese të importit të energjise elektrike nga ana e KESH

sh.a per muajin përkates dhe KESH sh.a ka eksport, kompensimi do behet me vleren monetare qe i korrespondon cmimit të eksportit në bandë të muajit “m” të shoqërisë KESH sh.a”;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI